



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 25, datë 16.10.2017

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TURISTIK “41°N19°E”,
NË FSHATIN SHETAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “MWPlan” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin “Ndërtimi i Kompleksit Turistik “41°N19°E”, në fshatin Shetaj, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 23.03.2015, me subjekt zhvillues shoqërinë “MWPlan” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 23.03.2015 nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

